

Eris Rusi (1983 –) Doktor i shkencave nëstudime letrare, pedagog i letërsisë në Fakultetin e Edukimit dhe të Filologjisë, Universiteti "Fan S. Noli" Korçë, shkrimtar, përkthyes, kryetar i Klubit të Shkrimtarëve "Bota e Re", Korçë, mentor i studentëve të komunitetit rom në kuadër të projektit të qëndrueshëm për mësimdhënie në favor të komuniteteve, *RomaVersitas Albania*.

Ka kryer shkollën tetëvjeçare (shkolla "Sotir Gurra") dhe të mesme (gjimnazi "Raqi Qirinxhi") në Korçë, ku u diplomua me medalje ari, për rezultate të shkëlqyera në të katër vitet e studimit. Ka kryer studimet e larta në Universitetin "La Sapienza", Fakulteti i Shkencave Humane, Romë, Itali. Diploma e nivelit të parë në *letërsi bashkëkohore* (2002–2005), me vlerësim final 110/110 me lavdërim, me temën "Jeta, vdekja dhe mrekullitë në Italinë magjike".

Diploma e nivelit të dytë në këtë Universitet, nga viti 2005–2007 është diplomë magjistrale në *tekst, gjuhësi dhe letërsi*. Vlerësimi final, 110/110 me lavdërim, me temën "Kritiku dhe artisti Buxati në zbulim të misterit". Për rezultatet e arritura, iu ofrua nga Universiteti "La Sapienza" mundësia e një masteri të dytë, pranë Institutit të specializuar në *formimin, zhvillimin dhe komunikimin* "Comunika", Palombi Editore, Romë, Itali, me drejtimin "Editori dhe komunikim", nga viti 2007–2009, ku u diplomua maksimalisht.

Me kthimin në Shqipëri, në periudhën 2009–2012 punoi si pedagog i ftuar pranë Universitetit të Tiranës, departamenti i gjuhës italiane, dhe si pedagog i brendshëm pranë Universitetit Europian të Tiranës nga viti 2010–2011. Në periudhën 2012–2015 mbrojti doktoraturën në "Studime letrare", Fakulteti "Histori-Filologji", departamenti i letërsisë, Universiteti i Tiranës, me rezultatin "Shumë mirë".

Nga viti 2012 e në vijim, është pedagog i letërsisë pranë Universitetit "Fan S. Noli". Aktivitetin letrar e ka të përfshirë në publikime brenda dhe jashtë vendit, ku mund të përmenden: 1. "Kohë çmendurie" – tregime, 1998; 2. "Vajza misterioze" – tregime, 1999; 3. "Ferri i moshës sime" – roman, 2000; 4. "Xholina" (Giolina) – roman, 2001; 5. "Një botë kundër meje" – tregime, 2003; 6. "Dashuri me një të panjohur" – tregime, qershor 2004; 7. "Udhëtari i natës" – tregime, korrik 2007. Në Itali është publikuar libri "La casa misteriosa", përmbledhje tregimesh, me shtëpinë botuese "Il Filo", në nëntor 2007. Për këtë krijimtari artistike është vlerësuar me këto çmime kombëtare, të organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

Çmimi i parë, tetor 1999; çmimi special "Muza e mbrëmjes", qershor 2000; çmimi i parë, prill 2001; çmimi i parë (karriere), qershor 2002; fitues i çmimit të parë në prozë, në konkursin kombëtar të letërsisë "Zef Serembe", i organizuar në Laç, 2002; fitues i çmimit të Madh Kombëtar në Prozë, me librin "Udhëtari i Natës", organizuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Ka përkthyer librin "Netët e vështira", të autorit Dino Buxati, në vitin 2016 me shtëpinë botuese "Ombra GVG", financuar nga një projekt i fituar me Ministrinë e Jashtme italiane.

Pjesëmarrja në projekte dhe trajnime përmbledh përfshirjen në programin "Roma Versitas" – *Ref project in training Roma students*, 2014 e në vijim, *Enchase Tempus Project "Koblenz Summer Academy"* Koblenza-Landau Germany – trajnim profesional mbi sigurimin e cilësisë në universitete, *Eureqa Tempus Project*, trajnim profesional mbi sigurimin e cilësisë në universitete, *Green Tech (Erasmus Mundus) project*, shkëmbim akademik për mësimdhënie në Porto, Portugali, shtator–tetor 2015, *Erasmus project*, shkëmbim akademik për mësimdhënie, në Universitetin e IASI-t, Rumani, maj 2017 etj.